



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1253/Prot.
1

Tiranë 30.4.2020

VENDIM

Nr. 11, datë 30.04.2020

***“Mbi notën mesatare të pranimit të studentëve në disa programe bachelor,
për vitin akademik 2020-2021, në Universitetin e Tiranës”***

Mbështetur në nenin 38 gërma dh; në nenin 74, pika 1; në nenin 83, pika 2 të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; në nenin 31 gërma f, të Statutit të Universitetit të Tiranës; në relacionet me argumentimet përkatëse të paraqitura nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e tij të datës 30.04.2020,

VENDOSI:

1. Të përcjellë në vemendje të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në kuadër të përgatitjes së projekt vendimit të Këshillit të Ministrave për kriterin e notës mesatare në pranimet në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve, për vitin akademik 2020-2021, mospërfshirjen e programeve të studimit të ciklit të parë bachelor, që zhvillohen në Universitetin e Tiranës, me kriterin e notës mesatare të diferencuar, pasi programet e studimit të ciklit të parë bachelor, që zhvillohen në Universitetin e Tiranës, nuk janë në fushën e mësuesisë.
2. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF.DR. MYNYR KONI

